



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.21/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare (OJQ) "Instituti i Kosovës për Drejtësi", paraqitur kundër Njoftimi të 12 dhjetor 2025 të Zyrës për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike të KQZ-së, për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, që do të mbahen me datën 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 16.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET e bazuar ankesa e OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi e paraqitur kundër Njoftimi të 12 dhjetor 2025 të Zyrës për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike të KQZ-së, me të cilin është refuzua kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, që do të mbahen me datën 28 Dhjetor 2025,

II. ANULOHET Njoftimi i dt. 12 dhjetor 2025 i Zyrës për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike të KQZ-së, dhe lënda i kthehet të njëjtës në rishqyrtim dhe në rivendosje.

A r s y e t i m

Më datë 13.12.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e parashtruar nga organizata joqeveritare "Instituti i Kosovës për Drejtësi"- IKD, në të cilën pretendon se përmes email-it më datë 12 dhjetor 2025, IKD ka pranuar një Njoftim nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, për refuzimin e aplikimit të organizatës IKD, për akreditim që të vëzhgojë zgjedhjet e parlamentare të 28 dhjetor 2025.

Parashtruesi i ankesës pretendon se në këtë rast konsideron se Zyra ka tejkaluar kompetencat e saj. Në njoftim e Zyrës thuhet se "aplikimi i OJQ-së IKD refuzohet". Bazuar në rregullat zgjedhore, për këtë çështje do të mund të vendoste vetëm KQZ, pasi të pranonte një rekomandim nga ana e Zyrës. Konkretisht, Rregullorja Zgjedhore nr. 08/2024 [Vëzhguesit e Zgjedhjeve], në nenin 3 ku përcaktohet procedura e aplikimit dhe shqyrtimit të aplikacioneve, paragrafi 4 përcakton se "KQZ miraton ose refuzon kërkesat..." Përmes dispozitave të këtij neni, Rregullorja përcakton që Zyra të shqyrtojë aplikacionin, ta njoftojë organizatën për korrigjim të dokumentacionit, e pas vendimit të KQZ, ta njoftojë organizatën lidhur me vendimin e KQZ. Në kuptim të kësaj, Zyrës në asnjë moment nuk i lejohet që të dal përtej përcjelljes së rekomandimit në KQZ-së, e të marrë vendim vetë. Më tej në ankesë theksohet se përveç që ka tejkaluar

kompetencat e saj, Zyra nuk e ka bërë të qartë bazën ligjore me të cilën ka refuzuar akreditimin e IKD, derisa ka keqinterpretuar dispozitat e Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në njoftimin e Zyrës thuhet: "Duke u bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 54 – Vëzhguesit e zgjedhjeve, paragrafi 1, e drejta për të kërkuar akreditim të vëzhguesve për zgjedhje u njihet subjekteve politike të certifikuara, organizatave joqeveritare, organizatave qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatave ndërkombëtare të specializuara që merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe përfaqësuesve të vendeve të huaja. Bazuar nëpërmbytjen e Statutit, konstatohet se OJQ-IKD nuk i përmbush kriteret epërcaktuara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, pasi në fushëveprimin e saj nukpërfshihet mbrojtja e të drejtave të njeriut apo zgjedhjet".

Sipas këtij interpretimi nënkuptohet se Ligji përcakton që organizatat të kenë në fushëveprim të saj "zgjedhjet" apo "mbrojtjen e të drejtave të njeriut". Mirëpo, kur flitet për fushëveprimtari të përcaktuar, Ligji ndan dy kategori. Neni 54 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, paragrafi 1, përcakton se: "Subjektet politike të certifikuara, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndërqeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje". Pra, në njërin anë ndahen subjektet politike të certifikuara, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndërqeveritare, për të cilat Ligji nuk përcakton se duhet të kenë në fushëveprimtarinë e tyre zgjedhjet apo mbrojtjen e të drejtave të njeriut. E në anën tjetër këto specifikime Ligji i kërkon vetëm për organizatat ndërkombëtare "...sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut". tutje shtone se IKD është akredituar nga KQZ edhe në vitet e mëhershme, derisa në statutin e saj kishte fushëveprimtari të njëjtë, siç ka edhe sot.

Për më tepër, sipas ligjit të procedurës administrative dhe standardeve që KQZ do të duhej zbatonte gjatë ushtrimit të fushëveprimtarisë së saj, çdo vendim administrativ që e miraton duhet të jetë i arsyetuar dhe transparent, si dhe duhet të garantojë të drejtën për të përdorur mjete juridike për kundërshtim. Në rastin konkret, vendimi për refuzimin e aplikimit të IKD-së nuk përmban arsyetim të qartë dhe të detajuar, duke e bërë të pamundur verifikimin e bazës ligjore të vendimit si dhe mungon e drejta e informimit lidhur me këshillën juridike për ta kundërshtuar këtë vendim. Kjo Shkel parimin e ligjshmërisë, transparencës dhe të drejtës për mbrojtjejuridike, dhe krijon hapësirë për arbitraritet dhe politizim në marrjen e vendimeve.

Mirëpo, qëllimi i kësaj organizate dhe aktivitetet e saj, janë pikërisht të lidhura drejtpërdrejt me të drejtat e njeriut, të cilat rrjedhimisht paraqesin edhe mision të organizatës. Sipas statutit të saj, IKD është e themeluar me qëllim të: a) promovimit të sundimit të ligjit; b) integriteteve evropiane dhe monitorimit dhe mbështetjes së institucioneve publike të Kosovës në zbatim të legjisllacionit të Kosovës si dhe procesit të përafrimit të legjisllacionit vendor me standardet tona të mira ndërkombëtare dhe të drejtës së Bashkimit Evropian; c) Edukimit dhe promovimit të gazetarëve dhe medieve profesionale në Kosovë; d) Ngritja e vetëdijes institucionale dhe publike nëfushën e sundimit të ligjit. e) Ofrojë ndihmëjuridikefalas për qytetarët, në përputhje me legjisllacionin e zbatueshëm; i) Edukimi, zhvillimi profesional dhe promovimi i juristëve të rinj. j) Zhvillimi profesional dhe promovimi i zyrtarëve dhe profesionistëve ligjorë në avancimin e ofrimit të shërbimevejuridike gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Pra, IKD, ka mandat të qartë në punën e saj që lidhet me promovimin e sundimit të ligjit, transparencës dhe llogaridhënies si elemente thelbësore të proceseve zgjedhore. Sundimi i ligjit, integriteti institucional, monitorimi i institucioneve publike, edukimi, ndihma juridike falas janë komponentë që lidhen drejtpërdrejt me fushëveprimtarinë e punë së IKD. Andaj, pretendimi se një organizatë si IKD që punon për sundimin e ligjit, integritetin institucional, monitorimin e institucioneve publike, edukimin dhe ndihmën juridike nuk ka të bëjë me të drejtat e njeriut përbën arsyetim të papranueshëm dhe joracional. Të drejtat e njeriut janë kategori kushtetuese,

koncept juridik e social, të përbëra nga një numër i madh komponentësh, që nuk mund të kufizohen vetëm në termin linguistik "të drejta të njeriut". Kështu, përveç keqinterpretimit të Ligjit, Zyra shkel edhe standardet ndërkombëtare. Praktikrat ndërkombëtare të OSBE/ODIHR, Këshillit të Evropës dhe standardet e demokracive perëndimore e njohin rolin e organizatave të shoqërisë civile në vëzhgimin e zgjedhjeve bazuar në misionin e tyre për transparencë, llogaridhënie dhe interes publik, jo vetëm nëse kanë të shkruar galën "zgjedhje" apo "drejtat e njeriut" në statut. Derisa aktivitetet e IKD paraqesin fushëveprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut edhe sipas indikatorëve të trupave ndërkombëtarë. Në mesin e këtyre dokumenteve është edhe "The Rule of Law Checklist" e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës. Mes tjerash, në këtë dokument i cili përmban indikatorët e Komisionit të Venecias, theksohet se mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut realizohen vetëm përmes respektimit të sundimit të ligjit dhe se sundimi i ligjit është jetik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky vendim cenon të drejtën e organizatave joqeveritare për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, si një mekanizëm i rëndësishëm i transparencës dhe llogaridhënies. Andaj, IKD kërkon që PZAP ta pranojë ankesën si të bazuar dhe që Paneli të vendos vet për çështjen e objektit lëndor, duke akredituar IKD-në për vëzhgimin e Zgjedhjeve të Parakohshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që do mbahen më 28 dhjetor 2025.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sqaron se në kategorinë e organizatave joqeveritare vendore me rastin e aplikimit për akreditim, në përputhje me Rregulloren 08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, kërkojnë dokumentet si në vijim: Formularin e aplikimit për akreditim të OJQ të plotësuar me të gjithë të dhënat e kërkuara; Listën e vëzhguesve të plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara; Certifikatën e regjistrimit të OJQ; Statutin e OJQ. Instituti i Kosovës për Drejtësi ka aplikuar përmes platformës elektronike, ka aplikuar për akreditim për vëzhgim të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sipas Statutit të ngarkuar në platformë, Zyra ka vërejtur se në nenin 3 të këtij dokumenti, janë përfshirë shtatë (7) pika: 1. Promovimi i sundimit të ligjit; 2. Integrimet eufopiane dhe monitorimit dhe mbështetjes së Institucioneve publike në zbatim të legjislacionit të Kosovës si dhe procesit të përfitimit të legjislacionit vendor me standardet më të mira ndërkombëtare si dhe të drejtës së Bashkimit Europian, c)Edukimi i cihe promovimi i gazetarëve dhe modeleve profesionale në Kosovë; d)Ngritja e vetëdijes institucionale sihe publikë në fushën e sundimit të ligjit; e)Ofrojë ndihmë juridike falas për qytetarët në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm; f)Edukimi, zhvillimi profesional dhe promovimi i juristëve të rinj;g)Zhvillimi profesional dhe promovimi i zyrtarëve dhe profesionistëve ligjor në avancimin e ofrimit të shërbimeve juridike gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Duke pasquruar parasysh që sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, më saktësisht paragrafi 1 i nenit 54, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e sikurse dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat metren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut kanë të drejtë të kërkojnë akreditim për vëzhgim të procesit zgjedhor në Kosovë, Pas verifikimit të Statutit të OJQ vendore Instituti i Kosovës për Drejtësi- IKD, Zyra ka vërejtur që OJQ nuk përmbush kriteret e përcaktuara me këtë Ligj nisur nga fakti se sipas Statutit, në fushëveprimin e saj nuk përfshihet mbrojtja e të drejtave të njeriut apo zgjedhjet. Aplikimi i Institutit të Kosovës për Drejtësi, nuk ka arritur të rekomandohet nga Zyra për akreditim apo refuzim të akreditimit dhe rrjedhimisht nuk ka vendim të KQZ për këtë rast.

Aplikimi i Institutit të Kosovës për Drejtësi, për akreditim për vëzhgim të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës është ende në trajtim dhe do të ketë rekomandim nga Zyra për këtë çështje me ç'rast do të ketë edhe vendimarrje.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, përgjigjet në ankesë të KQZ gjeti se:

- Ankesa është e bazuar

Paneli vlerëson se në bazë të shkresave të lëndës, ankesës se ankusit, si dhe pergjigjes në ankesë, rezulton se OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi, ka aplikuar për akreditim si OJQ Vendore në Zyrën për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ për Vezhgimin për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës që do të mbahen me datë 28 Dhjetor 2025. KQZ- Instituti i Kosovës për Drejtësi"- IKD, më datë 12 dhjetor 2025, ka pranuar një Njoftim nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, për refuzimin e aplikimit të organizatës IKD, për akreditim që të vëzhgojë zgjedhjet e parlamentare të 28 dhjetor 2025, për arsye se, gjatë verifikimit të Statutit të OJQ-IKD, zyra ka vërejtur se OJQ në fjalë nuk përbush kriteret e përcaktuar me nrin 54 paragraf 1 i LZP, nisur nga fakti sipas statutit në fushëveprimin e saj nuk përfshihet mbrojtja e të drejtave të njeriut apo zgjedhjet. Ndërsa në pergjigje të KQZ-së ka theksuar, aplikimi i Institutit të Kosovës për Drejtësi, nuk ka arritur të rekomandohet nga Zyra për akreditim apo refuzim të akreditimit dhe rrjedhimisht nuk ka vendim të KQZ për këtë rast, dhe kështu është ende në trajtim dhe do të ketë rekomandim nga Zyra për këtë çështje me ç'rast do të ketë edhe vendimarrje.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në Njoftim të datë 12 dhjetor 2025, i cili njoftim cenon të drejtat e palës ankuese, vlerëson se përfundimin e KQZ në këtë njoftim nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshme, nga arsyet në vijim.

Paneli vlerëson se vendimi i atakuar është i kontradiktor i paqartë dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës, kjo pasi që KQZ në njërin anë në arsyetim të njoftimit-konsideron se OJQ-IKD nuk ka plotësuar kushtet ligjore për akreditim në bazë të nenit 54 të LZP paragraf 1, ndërsa në pergjigje të KQZ-së ka theksuar, aplikimi i Institutit të Kosovës për Drejtësi, nuk ka arritur të rekomandohet nga Zyra për akreditim apo refuzim të akreditimit dhe rrjedhimisht nuk ka vendim të KQZ për këtë rast, ende në trajtim dhe do të ketë rekomandim nga Zyra për këtë çështje me ç'rast do të ketë edhe vendimarrje. Andaj Paneli tani për tani e ka të paqartë se cili është vendimarrja definitive e KQZ për faktin se, vendimi i atakuar dhe pergjigja e KQZ janë kontradiktore dhe nuk sqarojnë drejtë këtë çështje administrative, përkatesisht vendimi i ankimuar është i mangët kontradiktor dhe i paqarte, si dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës, andaj KQZ ka për obligim që përcaktoj qartë vendimarrjen në këtë rast.

PZAP vlerëson se arsyetimi i njoftimit të ankimuar është i mangët jo i plotë dhe nuk ka elaboruar të gjitha çështjet dhe faktet vendimtare që kanë të bëjnë me këtë çështje administrative sa i përket refuzimit të kërkesës për Akreditim, Njoftimi i kontestuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenëve 47 dhe 48 të LPPA-së. Neni 47 paragraf 1.1 dhe 1.4 të LPPA-së parasheh se; "*Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes, 1.4. pjesën përfundimtare, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike).* Andaj akti administrativ është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e të lartcekura të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga të cilat rrjedh detyrimi i organit që në aktin administrativ të paraqes arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare të çështjes, si dhe njoftimi i ankimuar nuk përmban këshillën juridike për ankesë. Një arsyetim i aktit administrativ që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtënkës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

KQZ nuk ka dhënë arsye për refuzim të akreditimit dhe njëherit as në pergjigje në ankesën e palës ankuese nuk ka dhënë arsye për të qartësuar arsyen e refuzimit, apo trajtimin e lëndës në vazhdim siç ka theksuar në pergjigjen e saj. Pala ankuese ka të drejtë që nga organi kompetent të marrë

përgjigje të arsyetuar për rastin e tij, përkatësisht për refuzimin e akreditimit, e cila e drejtë buron nga neni 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndërlidhur me nenin 6 të KEDNJ.

Paneli vlerëson se vendimi i KQZ është në kundërshtim me dispozita ligjore të 47 dhe 48 të LPPA, dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili e parasheh te drejtën marrë përgjigje të arsyetuar për ankesën e tij. Nga këto arsye, Paneli ka kthyer rastin në rivendosje në KQZ, në mënyrë që KQZ të vendos kërkesën për akreditim në bazë të dispozitave ligjore që rregullojnë këtë çështje.

Paneli vlerëson se nga dispozitat e lartcekura, rezulton se vendimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për çka vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, dhe urdhëroi KQZ-në që të rishqyrtoj vendimin sipas nenit 118 par.5 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe dispozitave nga neni 13 par. 11 të Rregullores nr.01-2025 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZP.Anr.21/2025, datë: 16.12.2025

